



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1206 prot.

Korçë, më 19. 06. 2026

**THIRRJE PUBLIKE
PËR
SHPREHJE INTERESI**

Drejtuar: **PERSONELIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË**
DEPARTAMENTEVE TË FAKULTETIT TË BUJQËSISË
DEPARTAMENTEVE TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTEVE TË FAKULTETIT TË EKONOMISË
DEPARTAMENTEVE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE NATYRORE DHE
SHKENCAVE HUMANE

Në datën 06.07.2026 përfundon mandati i anëtarëve të Bordit të Administrimit përfaqësues të universitetit. Bazuar në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 48 dhe Statutin e Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, neni 33, Senati Akademik shpall thirrjen publike për shprehje interesi për kandidim për anëtar të Bordit të Administrimit, përfaqësues të universitetit.

Kandidatët përfaqësues të personelit akademik mund të propozohen nga departamentet ose mund të vetëkandidohen dhe më pas Senati Akademik i universitetit përzgjedh 3 kandidatë për në Bordin e Administrimit, me mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Kërkesat për kandidim të paraqiten pranë Zyrës së Protokollit të universitetit. Ato do të pranohen deri në datën **30.06.2026**, ora **14:00**.

Pranë sekretarive të departamenteve do të gjeni modelin e formularit për aplikim për anëtar të Bordit të Administrimit.

**KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Lorenc Ekonomi**